



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E LIPJANIT**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**



**REPUBLIKA KOSOVA**  
**OPSTINA LIPJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.08.2024
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – gusht 2024

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, ju dorëzon:

**RAPORTIN MUJOR**  
**TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.08.2024-31.08.2024**

## **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT**

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit gusht 2024-janë pranuar gjithsejtë 61 kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë 37 lëndë, që në total rezulton të jenë 98-lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 70 kërkesa, 45 të miratuara, 24 të refuzuara dhe 1 e ceduar.

Për shqyrtim barten 28 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e planifikimit hapësinor është vazhduar me:

Intensifikimin e aktiviteteve për shqyrtimin e kërkesave për legalizimin e ndërtesave pa leje. Në këtë proces, deri me tani kemi arritur të shqyrtojmë një numër të konsiderueshëm të kërkesave. Aktualisht në shqyrtim kemi edhe 3 lëndë.

-Kemi hartuar Raportin për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës për periudhën e kaluar një vjeçare (03.07.2023 – 03.07.2024) i cili Raport duhet të bartet për shqyrtim në seancen e radhës të Kuvendit të Komunës.

- Janë përgatitur dhe dorëzuar detyrat projektuese për disa projekte infrastrukturore.

Gjatë këtij muaji kemi vazhduar dhe përfunduar aktivitetet në kuadër të Komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale me qëllim të realizimit të projekteve sipas Vendimeve të Kuvendit të Komunës të miratuara me datën 29.03.2024.

### ***Aktivitetet themelore për muajin vijues:***

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i hartimit të detyrave projektuese për projekte të ndryshme infrastrukturore.

Vazhdimi i menaxhimit të lëndëve në periudhën e shfrytëzimit të pushimeve vjetore.

## STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Të pezulluar	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	8	3	5		1		5
2.	Leje ndërtimi	15	8	10		3		10
3.	Leje renovimi, apo vendosje e objekteve të përkohshme	0	0					0
4.	Leje rrënimi	1	0			1		0
5.	Certifikatë përdorimi	0	2			2		0
6.	Kërkesa për pëlqime parimore	1 <sup>1</sup>	-	1				0
7.	Akte nga MMPHI me efekte juridike	3		2				1
8.	Nr. i shtëpisë /adresa	0	1	1				0
9.	Informacione urbane	6	2	6				2
10.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	6	6	2		6		3
11.	Legalizimi/ Në listë të pritjes			1				
12.	Njoftim për palen/ftesa							
13.	Tërheqje e lëndës dhe vendimi për pushimin e procedurës	5 <sup>2</sup>		3				2
14.	Ndërrim destinimi (tokës)	1				1		0
15.	Ankesa	2	1			3		0
16.	Kërkesë për mbrojtje mjedisore	1					1	0
17.	Kërkesa për pezullim të procedurës	1						1
18.	Vendosje e paneleve solare në ndërtesa	2				2		0
19.	Kërkesa të tjera	3	9	9		3		0
20.	LMK	6	4	4		2		4
21.	Njoftime		1 <sup>3</sup>	1				0
	Gjithsejtë:	61	37	45		24	1	28

Brenda muajit gusht 2024 janë pranuar 5 kërkesa të veçanta për plotësim dokumentacioni, tri prej të cilave janë trajtuar në kuadër të kërkesave bazë, kurse dy janë në proces shqyrtimi së bashku me kërkesen bazë.

<sup>1</sup> Pëlqimi për vendosjen e shi-matësit

<sup>2</sup> Dy kërkesa kanë të bëjnë në procesin e legalizimit kurse një tërheqje e lëndës ka të bëjë me kushte ndërtimore.

<sup>3</sup> DPUMM ka lëshuar edhe 4 njoftime të tjera lidhur me lëndë të caktuara të cilat ishin në proces shqyrtimi.

Po ashtu DPUMM ka pranuar edhe 5 kërkesa të tjera nga MMPHI për çështje mjedisore, nga të cilat nuk rrjedhin veprime të shqyrtimit të mëtutjeshëm juridik, përveç njoftimit të inspektorit mjedisor me ato akte.

Duke përfshirë edhe 5 kërkesa për plotësim dokumentacioni dhe 3 kërkesa për detyra projektuese, DPUMM gjatë muajit gusht ka pranuar gjithsejtë 69 kërkesa të natyrave të ndryshme. Përveç kësaj, gjatë muajit gusht janë realizuar me dhjetëra konsultime me palë sipas kërkesës së tyre.

#### DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit gusht 2024 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

#### SFIDAT:

- Muajve të fundit jemi duke u ballafaquar me sfida të mëdha dhe presion të palëve në trajtimin e kërkesave për kushte dhe leje ndërtimore ku faktor themelor është çështja pronësore e disa rrugëve të cilat me vite të tëra janë publike, por që në të dhënat kadastrale pronësia e tyre është private. Po ashtu në disa raste, përveç tjerash sfiduese është aprovimi i ankesave të palëve nga MMPHI për të drejten e çasjes në rrugë të planifikuara me HZK por të cilat rrugë nuk janë hapur dhe dhe një pjesë e tyre është planifikuar nëpër parcela private.
- Sfidë tjetër lidhur me lejet ndërtimore është rritja e densitetit të banimit në zona të caktuara, sidomos në zonën e parë dhe të dytë të qytetit dhe mos zhvillimi koherent i infrastrukturës publike.
- Pezullimi i finalizimit të Raportit të VSM dhe PZHK dhe ndikimi i tyre në proceset tjera.
- Vështirësitë në hartimin e dokumentacionit teknik nga operatorët e kontraktuar.

#### Shënim:

Numrin e kërkesave të shqyrtuara të të gjitha natyrave për nga përmbajtja, kemi arritur ta sjellim në nivel të arsyeshëm të shqyrtimit brenda afateve kohore.

#### BUXHETI:

Gjatë muajit raportues kemi vazhduar me realizimin e të hyrave nga trajtimi i kërkesave për leje ndërtimore dhe kategoritë tjera. Gjatë këtij muaji janë realizuar të hyra si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:..... 113,499.84€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej: .....31,190.60€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....5,248.30€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....1,975.76€
- Te hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej .....0.000€

Shuma totale e të hyrave: .....151,914.50€

#### Shpenzimet:

Në procesin e shpenzimeve kemi vështirësi të theksuara për shkak të pamundësisë së planifikimit të saktë të kryerjes së hartimit të projekteve dhe sidomos lidhur me finalizimin e Raportit të VSM-së dhe shpenzimeve për PZHK. Procesi i PZHK-së aktualisht është pezulluar për shkak të rrethanave me të cilat i kemi njoftuar edhe anëtarët e Kuvendit Komunal

#### **Rekomandim:**

***Të shqyrtohet në Kuvendin e Komunës procesi i mëtutjeshëm i finalizimit të PZHK-së.***

***Të shqyrtohet mundësia e bartjes të një shume të caktuar të mjeteve financiare për qëllime të tjera.***